**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**
**Kuvendi i Komunës**
**-Kryesuesi i Kuvendit-**

**01Nr.60/01-11317/25**
**Kaçanik, 21.05.2025**

## FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e V (pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 30.05.2025 (e premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

____________________

Në mbledhjen e V (pestë) të Kuvendit të Komunës të datës 30.05.2025, do të shqyrtohet ky:

**REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

2. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2025;

3. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik;

4. Kërkesa e MBPZH për harmonizimin e Rregullores Nr. 02/2025 për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale, të Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

5. Kërkesa e MMPHI 3745-2/25 për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.06-350/01-8267/25 për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut, të datës 29.04.2025.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal of Kacanik**

**01Nr.060/01-8444/25**
***Kaçanik, 29.04.2025***

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29.04.2025. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.
Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës ishin 27 anëtarë-të gjithë.
Nga Ekzekutivit i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Suhad Dullovi- DBPZHR, Sali Malsiu-DSHMS, Qamil Stagova-DUKMM, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Fatlume Guri-Selimi- Zyra e Informimit, Arbnora Kuka-DSHMS, Mavije Murseli-Zyra e Kryesuesit, Makfire Malsiu-Zyra e KK.
Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.
Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Se pari iu përshëndes të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Kërkoj të mbahet një minutë heshtje, në shenjë nderimi për policin e vrarë, Muhamed Lika.
**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Atëherë, në shenjë nderimi për policin e vrarë, Muhamed Lika, kërkoj të mbajmë një minutë heshtje!

Vazhdojmë me punimet e mbledhjes: E hapi mbledhjen e katërt të rregullt të KK për vitin 2025, data 29 prill, me këtë:

**REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
3. Raporti Tre Mujor Financiar për Periudhën Janar – Mars 2025;
4. Projekt-Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Kaçanikut;
5. Draft-Rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale;
6. Propozim-Vendim Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale, pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut;
7. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

**Aprovoj**

**Rendin e punës prej 7 pikave.**

**1.** Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbalit i mbledhjes së kaluar e Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

**Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së III (tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, të datës 28.03.2025/ Lënda: 01Nr. 060/01-6206/25.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Konstatoj me kaluar në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave: Paraprakisht kërkoj që të dëgjoni secilin që merr fjalën dhe mos ndërhyni në diskutimet e asnjë anëtari të KK.

**Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** Shprehi ngushëllimet e mia për humbjen e policit Muhamed Lika, familjes, policisë së Kosovës, miqve dhe gjithë qytetit të Kaçanikut, për humbjen e një njeriu shembull si në luftë dhe në paqe. Lavdi jetës dhe kontributit të tij, për këtë Republikë që po tentojmë të bëjmë me të mirë çdo ditë. Bashkë ndjejmë me familjen dhimbjen e madhe që po e përjetojnë.

Disa nga pyetjet përsëriten sot këtu për shkak të mos reagimit të institucionit.

1. Trotuaret nga parkimi i veturave, po vështirësojnë qarkullimin e lirë të qytetarëve. Kush duhet me u përgjigjur në këtë drejtim?
2. Kanë kaluar gati 2 vite që kam kërkuar vendosjen e policëve të shtrirë në qytet dhe në zona tjera të frekuentuara, ku për shkak të shpejtësisë së madhe që zhvillohet, mund të rrezikohet jeta e qytetarëve. Pyetjet janë të qytetarëve, e jo të miat si Arditë.
3. Ndërhyrja në një shatk të komunës në rrugën "Ejup Dushkaja" në Dushkajë, kërkesë kjo e një qytetari, i cili atakohet çdo herë kur ka reshje shiu, se i shkakton telashe. Kërkesa është adresuar me datë 18 korrik 2018, përgjigje nuk i është kthyer asnjëherë. -Kam një kritikë, Pse nuk kam marrë përgjigje në pyetjet dhe kërkesat e mbledhjes se kaluar?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Para se me kaluar fjalën të tjerëve, ne e kemi paraparë si temë, Çështja e sigurisë në komunën e Kaçanikut, ashtu që edhe çështja e rënies së policit ndërlidhet me këtë temë. Diskutimet për këtë çështje mund t'i lëmë në këtë temë. Nuk na pengon shprehja e ngushëllimeve edhe tani, por i trajtojmë me gjatë në këtë temë.

**z. Burim Shehu:** Në fillim të rrugës " Besnik Begunca" pjesa kah lagjja e re, deri në përfundim të rrugës janë të hapura 5-6 gropa, të cilat nuk janë sanuar, e që paraqesin rrezik shumë të madh, pasi rruga është e frekuentuar, e cila rrugë lidhë dy fshatra. Në një pjesë të kësaj rruge nuk funksionojnë 7-8 drita. I njëjti problem për çështjen e dritave është edhe në rrugën: "Rushit Luta". Duhet me marrë veprime të nevojshme për rregullimin e dritave se është një lagje e banuar, lagjja është malore dhe paraqet rrezik për fëmijët e asaj lagjeje.

**z. Ekrem Livoreka:** 1. Fillimisht e kam një njoftim për KK. Njoftimi ka të bëjë me atë që, tani e tutje edhe zyrtarisht nuk jam pjesë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës-AAK. Në kuvend tani e tutje veproj si anëtar i pavarur.

2.Kërkesa ime ka të bëjë me DSHPE. Nga banorët e lagjes Gajre dhe Ivajë, kam kërkesë për pastrimin e rrugës, pasi jemi në sezonin e pranverës, rruga është shumë e qarkullueshme, kështu që mos të vjen deri të ndonjë aksident për çështje që tashmë janë të ditura, të cilat i ka pa edhe vet drejtori i drejtorisë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ekrem Livoreka, Njoftimin për dorëheqje nga Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës-AAK, e ka sjellë edhe me shkrim, i cili tashmë vepron në KK si anëtar i pavarur.
**z. Naim Beça:** Kam një kërkesë nga banorët e rrugës "Ismail Qemali" në Kaçanik, të pjesa të rrasa të bëhet vendosja e policëve të shtrirë, për sigurinë e fëmijëve. Në atë rrugë ka vetura të parkuara, rruga është një kahe dhe paraqet rrezik për ata që i kanë dyert afër rrugës. Banorët kanë kërkuar vendosja e pengesave rrugore, që mos të vjen deri të ndonjë aksident me fatalitet.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** 1. Pse mungon transparenca në publikimin e mbledhjeve të KK? Kohëve të fundit seancat e KK, nuk po zhvillohen drejtpërdrejtë, ndërkaq mungon pyetja ime në publikimin e incizimit të mbledhjes në faqen zyrtare dhe Yotube. Sipas personit përgjegjës, incizimi për shkaqe teknike është bërë me telefon. Ajo pjesë e cila ekziston në incizim me telefon, pse nuk i është bashkëngjitur pjesës tjetër për publikim. Si rezultat i kësaj, DUKMM për pyetjen që mungon, nuk ka kthyer përgjigje.

2. Duke vënë në pikëpyetje, seriozitetin në punë dhe përgjegjshmërinë institucionale në përgjithësi, i paraqes 2 çështje:

2.1 E para, në tre seanca po kërkoj përgjigja për qytetarët, për një kërkesë, përgjigja nuk po jepet. Pyetja e mbledhjes se kaluar, banorët e f. Kovaçec, kërkojnë të marrin përgjigje me shkrim në kërkesën e adresuar me tepër se 1 vit, që prona e tyre private të kthehet në publike, të asfaltohet dhe të emërohet rruga publike. Nuk e di pse kjo kërkesë po vonon për përgjigje?
2.2 Nga mbledhja e kaluar, mbetet pa përgjigje pyetja ime e shkurtër, e cila nuk u transmetua. A ka komuna jonë harta zonale? Kërkoj sinqerisht transparencë, që kërkesa të merret parasysh dhe të kthehet përgjigje me shkrim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për transmetimin e mbledhjeve, sapo me njoftojnë se platforma facebook nuk po i lejojnë më transmetimin e drejtpërdrejtë. Ka mundësi të transmetohen me vonë. Ndërsa në përgjigjen që ta ka dhënë zyrtari i IT për incizim me telefon për shkak të pengesave teknike, sigurisht ka pasur ndonjë pengesë në transmetim të seancës. Ne nuk kemi çka të fshehim këtu, të gjitha seancat i kemi publikuar dhe transmetuar, edhe ndryshimi i faqeve ka krijuar pengesa në transmetim edhe në atë çka duhet transmetuar ligjërisht.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Pyetja ime është për objektin në çarshinë e qytetit, për të cilin pyesin shumë qytetarë. Kur do të hapet shpallja publike për marrjen e lokaleve në shfrytëzim? Me intereson të di: Pse ka zgjatur kaq shumë realizimi i këtij projekti dhe a është bërë pranimi teknik i tij?

**z. Agim Çaka:** Në takimin që patëm me përfaqësuesin e "Bifurkacionit", pata një pyetje rreth sigurisë së rezervuarëve. Përgjigjen të cilën e mora, nuk me bëri shumë bindës. Përgjigja ishte: Rezervuarët janë të siguruar me kamera të sigurisë. Pyetja ime për ekzekutivin është: A keni qasje në kontrollin e sigurisë së rezervuarët e ujit sa i përket sigurisë fizike të rrethojave, dyerve, drynave e kështu me radhë?

**z. Betim Shala:** Kërkesa ime ka të bëjë me rrugën" Skënderbeu", gjatë punimeve të hekurudhës është dëmtuar në njërën anë trotuari komplet. Kërkoj që të vendosën pengesa në rrugë, ose të rregullohet trotuari në pjesën kah muri, për shkak se ajo rrugë është në afërsi të shkollës "Skënderbeu", gjë që paraqet rrezik, për shkak të shpejtësisë që zhvillojnë veturat.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje dhe kërkesat tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

**2.** Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit;

Në raport tregohet sa kanë arritur të zbatohen të gjeturat e auditorit, sipas planifikimit për zbatimin e tyre. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Raporti është një tregues i qartë sesi e keni menaxhuar paranë publike, duke u bazuar në të dhënat e auditorit. Auditori kishte marrë 21 mostra nga Mallrat dhe shërbimet. Në 19 prej tyre rezulton se nuk ishin marrë hapat për realizimin e pagesave. Kjo është një keç planifikim apo nuk keni bërë plan për një gjë të tillë. Të çështja A2 të mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rurale, kontrata fillimisht ishte 475 mijë euro, ju i keni dhënë 504 mijë euro, apo 29 mijë e 309 euro me tepër nga kontrata e nënshkruar, për shkak të menaxhimit jo të mirë, dhe tani del se ky rekomandim është i zbatuar. Pyetja shtrohet: Si është zbatuar? Ndoshta është zbatuar, por shuma 29 mijë e 309 euro nuk janë kthyer në buxhetin e komunës, por janë të operatori ekonomik. Nuk e di si mundeni me quajtur të zbatuar? Të çështja 3, janë specifikuar do vërejtje të dosjes së tenderit. Të specifikimi i brendit, rregullimi i muzeut në qytet, është bërë shkelje serioze, për shkak se po kërkohet brendi në një dosje, ku ky specifikim i brendit krijon pabarazi dhe ndikon në konkurrencë në prokurim publik. ZP ka përfshirë në dosje specifikimin e gjithë brendit të caktuar. Ky veprim mund shkaktoj pabarazi tek operatori, kufizim të konkurrencës etj. Pavarësisht se ky problem është eliminuar, është zbatuar, faktet flasin diçka tjetër. Mungesa e një operatori të brendshëm për përgatitje të dosjes së tenderit, mungesa e njohurive apo shkelje të qëllimshme të prokurimit publik. Mendoj se urgjentisht duhet të mbikëqyren këto procese, dhe të jenë me transparencë në mbikëqyrje këto procese të Prokurimit publik në komunë. Nuk munden me quajtur të zbatuar, pa kërkuar përgjegjësi të prokurimit. Ne kërkojmë pse është bërë ky specifikim i padrejtë. Duhet të merren masa dhe përgjegjësi. Kërkesë për auditorin: Të rishikohen të gjitha tenderët e mëhershme. P.sh. keni humbur projektin e rrugës: Runjevë-Stagovë-Kaçanik i Vjetër në vlerë 236 mijë euro, nga buxheti i komunës për shkak të këtyre parregullsive. Të B1, ku thuhet është zbatuar ky rekomandim, në raportin e auditorit është konstatuar një shkelje serioze. Komuna ka nisur procedurat e prokurimit, pastaj ka filluar puna në terren, pa pasur projekt nga ekzekutivi të përgatitur me parë siç kërkohet me ligj. Në tre raste konkrete, vlera e projektit ka qenë 295 mijë euro, ky është një dështim në planifikim, në aspektin e procedurave ligjore dhe ekziston rreziku për rrezikimin e fondeve publike etj. Të thuhet se ky rekomandim është i zgjidhur dhe i zbatuar, mendoj se këtë e keni pasur me së lehti të zbatoni, sepse keni punuar pa projekt, fillimisht i keni kryer procedurat e prokurimit, punimet në rrugë, pastaj e keni bërë projekti, që është dashur me punuar në fillim dhe e keni quajtur rekomandim të zbatuar. Ky është absurditet. Kërkojmë një përgjegjësi për shkelje, sepse taksapaguesit, nuk duhet të paguajë kosto, për shkak të papërgjegjësisë së pushtetit. Disa rekomandimet të cilat i quani pjesërisht të zbatuara, nuk ka kuptim, se rekomandimet ose zbatohen ose jo, se nëse është pjesërisht e zbatuar, ka ende shkelje, mungesë të seriozitetit të pushtetit lokal për t'i trajtuar me seriozitet të gjitha rekomandimet e auditorit. Kërkoj që të gjitha rekomandimet të zbatohet dhe KK të jepet raporti detaj për secilin rast. Të thuash se rekomandimi është zbatuar pjesërisht, kjo nuk është në rregull, se rekomandimi sipas ligjit, ose zbatohet ose nuk zbatohet fare, se nuk ka gjysmë përgjegjësie kur është në pyetje paraja publike e qytetarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kategoritë e zbatuar dhe pjesërisht e zbatuar, janë kategoritë që i ka themeluar auditori. Edhe në raportet e tyre janë kështu, ne nuk i kemi shpikur këto shprehje. Për ato që janë pjesërisht, ka filluar zbatimi i tyre, por nuk kanë përfunduar. Të gjeturat tjera, përgjegjësia i takon secilit, por çështja është se që 3-4 vite raportet e auditimit janë pa theksim të çështjes, se kur gjetjet janë të mëdha, raporti bëhet objekt i prokurorisë për hetim për vepra

penale, se kjo është bërë tani edhe ligjore. Raporte pa të gjetura nuk ka me pasur asnjëherë kushdo që është në pushtet. Jemi në mesin e komunave për raportet me të mira të auditimit, me pak të gjetura, duhet vazhdojmë të përmirësohemi edhe tutje, që të kemi raporte edhe me të mira, të gjeturat të eliminohen sa me tepër.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Nga raporti i auditimit, të çështja B3 -regjistrimi i menaxhimit të kontratave, këtu kontratat vërehen se nuk janë regjistruar në sistemin elektronik të platformës së e-prokurimi. Menaxherët nuk e kanë nisur regjistrimin siç kërkohet. Kjo tregon mungesë të zbatimit të rregullores dhe nevojës për veprim të mëtutjeshëm.

**z. Bahri Selimi:** Ashtu siç e potencoj edhe kryesuesi, ka qenë pyetje edhe në KPF, çështja e zbatimit pjesërisht të rekomandimeve në raportin e auditimit, kemi të bëjmë se është bërë përpjekje, janë marrë veprime të nevojshme, por nuk kemi arritur me zbatuar në tërësi. Vërejtjet që janë, ne nuk i mohojmë. Zbatimi i rekomandimeve, nuk do të thotë zhbërje e gabimeve për lëshime që i kemi bërë në ekzekutiv. Kur themi rekomandim i zbatuar, kryetari i komunës së bashku me stafin tjetër, janë zotuar dhe kanë marrë masa që ato gabime mos me ndodhë tutje mos me u përsëritur. Të A2 fjala vjen, tejkalimi i kontratave, ka ndodhë tejkalimi për 29 mijë euro, auditori e ka gjetur këtë shkelje, ne jemi zotuar që nuk do të ndodhë më. Specifikimi i brendit ka qenë gabim, nuk ka ndodhë nga ajo kohë jemi zotuar se nuk do të ndodhë me tutje. Për të gjeturat, raporti i auditimit është element hetuesie nëse ka dyshime të mëdha, ata e marrin lëndën dhe për zyrtarin përkatës mundet me u shqiptuar ndonjë dënim. Të B1, mungesa e projekteve, e kemi thënë se është zbatuar, ka projekte që janë realizuar pa pasur projekt detaj, ka thënë auditori, se nuk ka munduar me u bërë para masë, për shkak të disa rrethanave të caktuara, jemi zotuar se të gjitha projektet i paguajmë dhe i realizojmë. Të menaxhimi i kontratave të e-prokurimi, me procedura të reja po kërkohet, përpos menaxhimit fizik nga menaxherët, ku ne jemi me të koncentruar, se me ndryshe është me u kujdesur në mirëmbajtje të projektit fizikisht sesa me letra. Kjo i bien që menaxherët me u kthyer në zyre dhe me i bërë do raportime në mënyrë elektronike. Ka diçka interesim këtu, por ende nuk është zbatuar komplet.

**z. Agim Mani:** Unë nuk kam shpikur asgjë këtu, ky është realiteti. 29 mijë euro nuk iu kanë kthyer qytetarit, por qysh janë zbatuar operatorit ekonomik, më ndoshta nuk do të ndodhë, por është absurde me filluar punimet pa projekt, këtë duhet me kuptuar qytetarët sesi vepron ekzekutivi jonë. Ndoshta kjo nuk do të ndodhë më, por ka ndodhë. Specifikimi i brendit për shkak të 236 mijë euro, ka humbur projekti i rrugës: Runjevë-Sagovë dhe shumë e shumë tjera që nuk i keni cekur se nga kanë shkuar. Mbi gjysmë milioni i keni humbur për shkak të këtyre parregullsive. Duhet me dhënë përgjegjësi dikush për to, nuk mundemi me ikur aq lehtë. Nëse diku 29 mijë euro që i epën operatorit ekonomik për shkak të menaxhimit të dobët, dhe doni aq lehtë me kaluar, kjo nuk është e drejtë, këtu duhet me dhënë dikush përgjegjësi kush e ka menaxhuar projektin. Qysh i keni kryer procedurat e prokurimit pa projekt? Kjo është absurde. Ju po thoni se keni filluar me zbatuar dhe keni filluar prapë, unë po ju themi se prapë filloni me mendësinë e njëjtë. Të rregullimi i rrugëve lokale dhe rurale, a keni projekt të detajuar? Prapë i kryeni procedurat e prokurimit pa projekt të detajuar, vetëm me para masë, nuk keni projekt, prapë keni vazhduar me mendësinë e njëjtë, prapë auditori ua tërhequr vërejtjen dhe thoni se është e zbatuar, kjo mendësi e qeverisjes është shumë shqetësuese dhe kjo është në dëm të buxhetit të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me siguri asnjë kontratë njëburimore nuk është këtu. Të gjeturat janë element hetimi, dhe nuk besoj se ka ndonjë të gjetur ashtu siç po e interpretoni, se moti ishte marrë hetuesia. Ky është raport për zbatimin e rekomandimeve. Tani na vjen edhe raporti i auditimit për vitin 2024, sigurisht ka me pasur të gjetura, kemi me i diskutuar të gjeturat në

është mirë të gjeturat të jenë sa me të vogla dhe të natyrës sa me të thjeshtë, se paraja publike duhet të menaxhohet në mënyrën sa me të mirë të mundshme. Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i komunës,

**NJOFTOHET**

**Me Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit/Lënda: 01Nr. 470/03-7954/25.**

**3.** Raporti Tre Mujor Financiar për Periudhën Janar – Mars 2025;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Ky raport financiar është pasqyrë e qartë sesi funksionon ekzekutivi i komunës. Në raport janë paraqitur të HVK dhe shpenzimet. Shqetësimi ynë është çështja e planifikimit dhe realizimit të HVK. E vetmja mundësi e komunës që me mbledhë buxhet, janë të HVK. Të HVK nuk janë në harmoni me planifikimin, sepse në tre mujorin e parë janë inkasuar me pak mjete. Investimet Kapitale-IK thoni që janë 476 mijë euro, kërkoj përgjigje nga drejtori, a janë shpenzuar 476 mijë euro nga IK apo jo? Sipas mendimit tim, sipas këtij raporti, unë mendoj se IK nuk janë 13%, por 4.3%. Shpenzimet komunale nga viti i kaluar janë rritur. Në tabelën tjetër, shpenzimet komunale thuhet se janë 37 mijë euro, Mallrat dhe shërbimet 266 mijë euro, prej tyre 151 mijë euro janë të mirëmbajtja e rrugëve lokale, mbi 55%, ndërkaq 45 % janë të Mallrat dhe shërbimet, që është një kosto jashtëzakonisht e lartë të mirëmbajtja e rrugëve lokale. Të IK, janë 478 mijë euro shpenzime. Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari", segmenti Silcapor, a është realizuar ky projekt, janë shpenzuar 40 mijë euro? Rruga Bob-Kulla e Hasanit është në përfundim e sipër. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale, 60 mijë euro të shpenzuara. Të specifikohet se ku janë këto rrugë? Në arsim, ndërtimi i aneksit "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", janë planifikuar 200 mijë euro, janë shpenzuar 200 mijë euro. Në raport thuhet se me vendime të gjykatës janë shpenzuar 322 mijë euro, për mua është e pakuptueshme, ku thuhet vendimet gjyqësore të kontratave në arsim, janë në shumë 279 mijë euro, ndërsa 41 mijë euro të dëmi i parcelës. Të cila parcelë janë shpenzuar këto mjete? Sepse sipas këtij raporti 235 mijë euro janë shpenzuar në arsim me vendime të gjykatës, 40 mijë në shërbime publike , 45 mijë në urbanizëm dhe kadastër, 2 mijë euro për pagë jubilare të marra nga mallrat dhe shërbimet.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Komuna e Kaçanikut ka paguar për shpenzime të vendimeve gjyqësore 322, 473 euro. Këto pagesa janë bërë nga kategoria ekonomike, 2 mijë euro nga Mallrat dhe shërbimet, rreth 320 mijë euro nga Investimet Kapitale-IK. Nga kategoria ekonomike e IK janë realizuar pagesë prej 41 mijë euro, për kompensimin e një parcele me vendim të gjykatës themelore në Ferizaj. Për cilën parcelë keni paguar këtë dëm? Se kategoria e IK është me përdorë për mjete zhvillimore, e jo për me i mbuluar dëme e shkaktuara si pasojë e pa përgjegjësisë suaj, ku si rezultat i kësaj papërgjegjësie, qytetarët e komunës së Kaçanikut po pësojnë drejtpërdrejtë në IK, në vend se këto mjete të përdorën për projekte tjera në interes publik, tani po shpenzohen mjetet nga keç menaxhimi i vazhdueshëm që po e bëni.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Në këtë vit janë inkasuar me pak 13 mijë e 107 euro nga viti 2024 nga të hyrat indirekte, shumë bukur e madhe. Pagesat sipas vendimeve gjyqësore, janë 235 mijë euro. Na tregon drejtori se në këto pagesa a përfshihen, kompensimet e mësimdhënëseve sipas kontratës kolektive?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Edhe në KPF e kam ngritur çështjen e të HVK "Taksat tjera" që nuk janë të specifikuara, se ne nuk po e dimë qytetarët se çka po paguajnë. Vazhdimisht kam kërkuar nga drejtori me u bërë ky përmirësim, dhe të bëhen emërtimet sipas pagesave të

qytetarëve dhe kategorive të caktuara. Të shpenzimet, të rrugët rurale, janë shpenzuar 60 mijë euro, ndërkaq nuk cekën rrugët që janë shtruar dhe shumat e mjeteve. Duhet bëhet një specifikim i punëve që bëhen dhe i pagesave.

**z. Bahri Selimi:** Sqarim për pyetjen që e patëm në KPF, shuma e shpenzuar prej 60,606 euro për rrugët rurale, e dini ku kanë shkuar e po pyesni prapë. Këto mjete kanë shkuar sipas menaxherit të kontratës, të rruga Krivenjevë, 27, 248 është bërë një pagesë, 11,323 euro pagesa tjetër. Shuma 22,135 euro nga këto mjete janë marrë për vendime gjyqësore. Për rrugën 38,571 euro për rrugën Krivenjevë, ku është shtruar me zhavorr rruga. Krejt komunat e Kosovës janë duke u ballafaquar me kontratën kolektive të arsimit, ku çdo ditë tërhiqen mjetet dhe kështu është vendosur me proceduar mjete shtesë ministria, janë pajtuar krejt kryetarët e komunave, se nuk është obligim i yni, por vendimi është marrë nga gjykata Supreme që me u kryer nga komunat. Ne deshëm apo nuk deshëm, po përballem me këtë problem, duke cenuar kryesisht IK. Atë që e kemi qitur në letër, për shpenzimet gjyqësore janë të dhëna të sakta, nga 1janar-25 mars. Ne jemi duke ndjekur do procedura që mos me u paguar përmbaruesi, jemi duke i bërë do marrëveshje gjyqësore që me paguar vetëm borxhin real. Nga DA dhe zyrtarët financiar janë duke u bërë kalkulime me shpëtuar buxhetin, mos me u paguar kur punëtori ka qenë në ndonjë pushim, për shujta për transport. Disa mjete, si të çështja e rrugëve rurale, janë tërhequr pa dijeninë tonë, se ka raste kur thesari na i tërheqë vet mjetet apo vet ne. Shuma 332,473.94€ janë tërhequr nga 1-31 mars, 41.28 euro janë shpenzuar për një parcelë që është kontest gjyqësor në mes të komunës dhe qytetarit Halim Shurdhani. 279,434 euro janë komplet për arsimtarë që janë marrë nga IK. Prej MSh 2 mijë e 11 euro, ka të bëjë me një pagë jubilare të një zyrtari. Shuma e shpenzuar për IK që po e përmendi, 322,473 euro, këto janë marrë nga kodet përkatëse, që ekzistojnë projektet për sivjet, figurojnë që janë shpenzuar 478 mijë euro, 322 mijë euro janë marrë mjetet nga IK, një është për projektin e ndërtimit të aneksit të shkollës "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", janë edhe disa tjera. Ne mjetet sivjet i kemi të koduara nëpër projekte, por nëse ndodhë vendimi i gjykatës, merren mjetet të kodi i ndonjë projekti, se nuk ka mjetet rezervë ku mundem me i marrë mjetet. Nëse merren mjetet nga MSh e cenon diku ndonjë aktivitet të ndonjë drejtorie. Nëse merren të IK, atëherë atë projekt nuk mundesh sivjet me realizuar. Të Projekti i SHMP, investimi nuk është real, shpenzimi ka ndodhur, nuk ka keq planifikim as keq menaxhim, kush ka pësuar, qytetarët dhe ne. Nuk jemi vetëm ne duke paguar vendime gjyqësore, interesoni, krejt komunat e kanë këtë problem.

**z. Qamil Stagova:** Parcela për të cilën komuna ka bërë pagesë, është rruga e cila ka figuruar në emër të personit privat. Rruga është asfaltuar herët kur janë asfaltuar rrugët e Dushkajës, që 15 vjet, gjykata e ka shënuar që me këtë veprim të asfaltimit të rrugës, iu ka ulur vlera e tokës. Personi është ankuar, leje nuk ka marrë se kur është vendosur, krejt kanë qenë të kënaqur gojarisht, me vonë ka ndodhë kjo. Toka është kthyer në emër të komunës, mirëpo shuma 41 mijë euro është caktuar me ia paguar palës.

**z. Agim Mani:** Nëse bazohemi në këtë raport, qytetarët nuk e kuptojnë. Për atë kërkova me u sqaruar nga drejtori dhe me u bërë specifikim, se nëse thuhet se asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari" segmenti i Silcaporit, janë planifikuar 40 mijë euro, dhe janë realizuar, ndërkaq rruga nuk i ka filluar punimet, qytetari nuk e dinë këto çështje. Nëse thoni se janë planifikuar 200 mijë euro për aneksin e SHMP dhe i keni realizuar, nuk është realizim, se realizimi i aneksit nuk ka ndodhur. Në anën tjetër, shpenzimet e krijuara me vendime të gjykatave, nuk mundeni me i quajtur IK. IK për 3 muaj nuk janë 13%, por janë për TM3 vetëm 4.5%. Kjo është shqetësuese, se qytetarin me së tepërmi e prekin projektet infrastrukturore, si :rrugë, ujë etj.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me thënë se nuk e keni sqaruar, nuk keni të drejtë, se kjo çështje është e sqaruar. Drejtori e sqaroj qartë se nga cilat projekte janë tërhequr mjetet, nuk mundet me

shkuar ndryshe në këto kategori, pos realizim të mjeteve, por moskryerja e punimeve, se mjetet kanë shkuar për një destinim tjetër, u tregua qartë. Si mjet është realizuar në atë kategori, si punë nuk është kryer, se mjetet kanë shkuar për një destinim tjetër, me vendim të gjykatës për pagesat e kontratës kolektive, jo vetëm ne, por të gjitha komunat.

**z. Bashkim Luma:** Shumë mirë që po sqarohemi, është mirë me plasu në letër edhe për publikun. Tjetra, unë e di që Hani i Elezit e ka kryer çështjen e kontratës me marrëveshje, pa shkuar në gjykatë fare, se një shumë bukur e madhe shpenzohet kur lënda të shkon në gjykatë. Drejtor, është dashur me cekur projektin e aneksit të SHMP pse nuk është ekzistues, ku kanë shkuar mjetet, dhe të rrugët rurale, shuma 40 mijë euro që i ka tërheqë gjykata, nuk kanë shkuar për rrugë rurale. Këto ka qenë mirë me u sqaruar në fund të raportit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Janë të theksuara.

**z. Rrustem Zenuni:** Ne e kemi kuptuar se ku kanë shkuar mjetet financiare, ndërkaq ky tentimi propagandues nga një grup i caktuar me transmetuar ndryshe tek qytetarët nuk është në rregull. Unë mendoj se qytetarët nuk e meritojnë një gjë të tillë, kur dihet se krejt Kosova e dinë se për shkak të kontratës kolektive dhe për shkak të një personi të gabuar, po vuajmë ne nivelin lokal që po na i marrin mjetet gjykatat. Nuk e di pse bëhet zhurmë, kur dihet kjo çështje dhe është shënuar në letër, e sqaruar edhe nga drejtori. Nuk po e dimë ku është qëllimi, ose nuk po e kuptoj mendësinë e tyre, ose është në pyetje diçka tjetër. Nëse është qëllimi me mbrojtur interesin e qytetarëve, nëse reagoni sot ndaj drejtorit, duhet me reaguar sot edhe ndaj asaj ministrie, e cila me një vendim, e kanë shkëputur kontratën kolektive dhe na i kanë bartë obligimet neve. Është mirë me hedh fajin edhe në anën tjetër, se fajin e ka ministrja e arsimit. Është mirë me thënë si pasojë e atij vendimi, ne sot përballemi me këtë çështje, e jo me na i hedh akuzat se ku kanë shkuar mjetet.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Desha me pyetur drejtorin të IK periudha janar-mars, këtu kemi planifikim dhe shpenzim. Unë e kuptova se shuma 22 mijë euro nga shuma 60 mijë euro të pjesët rurale, janë paguar me vendime të gjykatës. Drejtor desha me pyetur: A je kursyer në kohë për me i bërë shtjellimet në tabelë. Nëse ashtu, pranoje që nuk ke dhënë sqarime të sakta të planifikimi dhe shpenzimi. A llogaritet shpenzim kapital shuma 22 mijë euro? Ky nuk është shpenzim kapital, mirë e potencoj edhe Agimi dhe të tjerët, nëse mjetet janë marrë, duhet me dhënë një sqarim më poshtë. Raporti planifikim-shpenzim, është raporti i IK, ndërkaq shuma 22 mijë euro nuk është shpenzim për IK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** U sqarua të planifikimi dhe shpenzimi, ato mjete janë të shpenzuara.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Pyetja është për drejtorin, jo për juve kryesues, se ju po jepni sqarime. Ju mundeni me bërë pyetje.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë kam drejtë me fol, kam të drejtë me diskutua, mos ndërhynë kur të diskutoj.
**z. Kadri Krivenjeva:** Nëse nuk mundesh me dëgjuar, e thjeshtë është kjo punë, mundeni me dalë jashtë, se këtu jemi në seancë, këtu jemi për debat. Ky KK e ka një rregullore të punës dhe atë rregullore duhet me zbatuar kryesues.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E di rregulloren, kur të flas unë, nuk e keni atë të drejtë me më treguar sesi flas, e drejta ime është me fol. Çështjet që po sqarohen disa herë, kërkoj mos të përsëriten.

**z. Bashkim Luma:** Pyetje për drejtorin: A mendoni se është dashur me u dhënë me shkrim ky sqarim, që me qenë ne me të qartë? Ne nuk patëm ndonjë qëllim për me nxjerrë askënd keq, që e potencoj kolegu me propaganduar, se ne tani e kuptuam, sqarimi është dashur me u dhënë me shkrim edhe për publikun.

**z. Bahri Selimi:** Ne nuk jemi këtu për me u lavdëruar sa mjete janë shpenzuar, se kur po dështojnë projektet, shqetësimi duhet me qenë edhe i juaji. Ne raportet çdo herë i krahasojmë me vitet paraprake. Nga raporti po del se kemi shpenzuar me tepër gati 400 mijë euro, por brenda këtyre, ne kemi menduar se është i mjaftueshëm fleta e fundit, që nuk e kemi bërë shpesh, por varësisht prej situatave, po duhet me shpalosë. Shuma 320 mijë janë tërhequr mjetet të IK, dhe kështu vazhdon deri në fund të vitit aty ku tërhiqen raportojmë. Sqarimi është dhënë edhe në KPF. Ne jemi transparentë për mjetet që janë marrë për vendime të gjykatave, se nuk kemi çka me fshehur në këtë drejtim. Edhe vet prezenca e drejtorëve këtu është për sqarime, se unë mundem me harruar ndonjë projekt, bile edhe ZKF e kam ftuar me ardhur për me pa që me gjeneruar raportin sa me adekuat me kërkesat e juaja, hezitojnë me ardhur. Këto shpenzime kanë ndodhur, ndërkaq halli i jonë është se po mbesim pa realizimin e projekteve që ju kemi premtuar qytetarëve. Pas muajit qershor jepet raporti 6 mujor, me në detaj do mundohemi me sqaruar.

**z. Selajdin Troni:** Edhe unë i përkrahi kërkesat për sqarime të nevojshme shtesë, si fjala vjen, nëse për projektin e SHMP kanë qenë 120 mijë euro, me sqaruar se janë marrë 20 mijë për qëllimin e caktuar, mjetet tjera kanë mbetur, që mos me zgjatur debati.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në tabela nuk mundesh me ndërhyrë, ndërkaq sqarimi ka pasur mundësi të jepet diku me poshtë.

**z. Agim Çaka:** Të shpenzimet e mjeteve për IK, janë 3,473,583 euro, janë shpenzuar 478mijë e 188 euro. Sipas meje, shpenzimi i mjeteve për IK nuk është i kënaqshëm, dhe si rezultat i kësaj, në fund të vitit kemi me u detyruar me bartë mjete në vitin vijues. Unë e shoh problem kur ka projekte e nuk ka mjete, ndërkaq me pasur mjete, e mos me shpenzuar me kohë, kjo është përgjegjësi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, raporti ishte sa për informim, konstatoj se Kuvendi i komunës,

**NJOFTOHET**

**Me Raportin Tre Mujor Financiar për Periudhën Janar – Mars 2025/Lënda:01Nr. 104/02-8099/24.**

**4.**Projekt-Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me herët ka qenë një rregullore e tillë, tani me ligjet e reja, rregullorja duhet të bëhet në bazë të ligjeve të reja. Drejtoresha është këtu, në rregullore ka punuar një grup punues. E hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Unë kam vërejtje në sistematizim të vendeve të punës, të DUKMM, të sektori i urbanizmit dhe planifikimit, nuk është planifikuar një zyrtar për gjeodezi. Është sektori i Gjeodezisë dhe Kadastrit në kuadër të DUKMM, është sektor në veti dhe kanë detyra tjera dhe shumë shpejtë munden me kaluar në kuadër të Agjencionit kadastral. Me qenë një zyrtar për gjeodezi, është primare, për kontrollimin e kushteve ndërtimore, me i kontrolluar pikat - (inxhinier ose arkitekt) që i kupton këto punë dhe me qenë përgjegjës për to. Unë mendoj se mundet me u shtuar këtu një zyrtar për gjeodezi- specialist për gjeodezi, mundet me qenë, inxhinier për planifikim hapësinor.

**znj. Dardana Tafili-Dauti**: Me hyrjen në fuqi të ligjit të pagave dhe harmonizimin e vendeve të punës të pagave nëpër komuna, është formuar një komision i cili ka punuar për klasifikimin e vendeve të punës për krejt administratën komunale. Komisioni në detaje është thirrur në

vlerësimin, kualifikimit dhe përvojën e punës dhe kanë përgatitë draft rregulloren që e keni ju. Është bërë një punë, për rregulloren është kërkuar edhe këshillë juridike, vërejtjet e vogla sipas këshillës juridike që janë dhënë, janë korrigjuar. Rregullorja shkon në vlerësim të ligjshmërisë në MAPL. Betimi e dha një propozim. Ne si drejtorë kemi qenë të gjithë të informuar, janë sjellë komisionit propozimet tona, është drejtori i Urbanizmit, nëse e sheh drejtori të arsyeshme me shtuar.

**Kryetari i Komunës:** Përgjigje për Betimin, procedura e kalimit të sektorit të Kadastrit në Agjencion, nuk e di sa zgjatë. Në momentin që kalojnë, atëherë e parashohim një specialist për gjeodezi në drejtorinë e Urbanizmit, se për momentin është shumë herët me menduar, se nuk e dimë kur fillojnë dhe përfundojnë, se kemi pasur raste të sektori i Pylltarisë, procedurat kanë zgjatur që 5-6 vite. Tani ka filluar edhe kalimi i sektorit të Kadastrit, nuk e dimë sa zgjatë, kalojnë apo nuk kalojnë asnjëherë, kështu për momentin e lëmë kështu deri sa të ndodhë ndryshimi.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, draft rregulloren e shtroj në votim dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për (12 PDK, AAK, Kandidati i pavarur), Kundër votë nuk ka, Abstenuan 13 (8 LVV, 4 LDK, 1 NISMA). Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori vendim me të cilën,

**APROVOJ**

**Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Komunën e Kaçanikut/Lënda: 01Nr. 060/01-8175/25.**

**4.**Draft-Rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin;

**znj. Ardita Rrahmani:** Kam një kërkesë për ndryshim të nenit 28 alineja 1, që kategorive të parapara me UA për lirim nga pagesa në QKMF dhe ambulanta të mjekësisë familjare në gjithë komunën e Kaçanikut, t'i shtohet, pjesëtarët e policisë së Kosovës, FSK dhe zjarrfikësit. Ky lirim nga pagesa të bëhet deri me sigurimin shëndetësorë, pasur parasysh që kjo kategori janë të parët në kontakt me rrezikun, ndërkaq lë të jetë komuna jonë ajo e cila shprehë mirënjohje dhe konsideratë edhe në këtë formë të punës së tyre 24/7 ndaj qytetarëve të vendit, duke qenë e vetëdijshme për inkasimin jo të madh të mjeteve për shërbimet e bëra për 1 vit në QKMF, duke qenë falënderues tej mase për shërbimet e tyre. Ky numër jo i madh i kësaj kategorie që propozoj të lirohen nga taksat nuk besoj se është rëndesë për buxhetin e komunës, pasi në bazë të informatave, janë diku 60 zjarrfikës, 150 ushtarë të FSK dhe 50 policë.

**z. Betim Shala:** Taksat e DUKMM, për nxjerrjen e vendimit për leje ndërtimi dhe inspektimin e ndërtimit për kategoritë II, është një UA i vitit 2018 për leje ndërtimi dhe rregullimin e infrastrukturës, i cili parasheh sesi arrihet deri të taksat për leje ndërtimi, duke bërë një llogaritje të m2 të cilat janë lëshuar në vitin paraprak dhe shpenzime. Taksa 2 € nuk mendoj se mundet me përfshirë inspektimin, se për inspektim ne nuk kemi grup të inspektorëve, se për leje ndërtimi janë 5 faza, duhet me kontrolluar arkitekti, inxhinieri i infrastrukturës, i elektrikes, i makinerisë dhe ai i ujësjellësit. Krejt këta duhet me u kontraktuara, para se me u bërë pranimi teknik dhe me u bërë inspektimi, kështu që mendoj që nuk janë të përfshirë në taksën 2 euro, ose është dashur me hequr kërkesën për inspektim, apo me u marrë pala me këtë. Në këtë rregullore nuk është paraparë, tarifa e ndikimit në infrastrukturë.

**z. Burim Shehu:** Të taksat motorike, neni 17, të lirimi i taksave komunale mbi mjetet motorike, paragrafi 1.7 ku thuhet se lirohen nga pika 1.3 e nenit 16, a është për të gjithë veteranët e UÇK,

për të gjitha mjetet motorike, apo është specifikuar me ndonjë pikë të veçantë? Tjetra, kategoritë e liruara nga shërbimet shëndetësore, a janë veteranët e liruar nga këto shërbime?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kategoritë e veteranëve janë të liruar nga shërbimet shëndetësore.

**z. Agim Mani:** Një plotësim të neni 16 që e ceku Burimi, të taksat komunale për regjistrimin e automjeteve, në aspektin profesional mendoj se nuk janë të renditura mirë, dhe kjo bien ndeshë njëra me tjetrën. Qëllimi është nëse kalon, me pasur zbatim me të mirë. Të mjetet motorike me 2 deri 4 rrota, deri në 50 cm, duhet me qenë mbi 50 cm. 5 euro, nën 50 cm. të jetë 5 euro. Automjetet për udhëtar deri në 3.5 ton 10 euro, pastaj pasuesi tjetër, automjetet për udhëtar mbi 3 ton 5 euro. Kur është në pyetje veteranët, ata lirohen nga pagesa e taksës për mjetet motorike të nenit 16, pika 1, paragrafët 1.1-1-3. Duhet të jetë kështu: Automjetet deri në 3.5 ton, 10 €, në këtë kategori duhet të lirohen veteranët, tjerat janë në rregull.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Ne rregullore ka punua një grup punues, janë marrë për bazë edhe rregulloret e komunave tjera, i kanë konsultuar edhe ligjet përkatëse. Kryesuesja e komisionit, Arbnora Kuka është këtu. Sa kam informacion unë, veteranët janë të liruar për vetura deri në 3.5 ton, ndërkaq të 1.4 kryesuesja me bënë me dije, se duhet të jetë mbi 3.5 ton.

**z. Agim Mani:** Veteranët të lirohen nga taksat edhe të paragrafi 1.3. automjetet për udhëtar deri në 3.5 ton. Të neni 27, të pagesat e shërbimeve shëndetësore, nenit 22 që iu keni referuar 2004 veteranët nuk lirohen, edhe pse nuk kemi paguar sa herë që kemi shkuar në QKMF. Neni 22 thotë: Lirohen: fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 15 vjeçare, nxënësit deri në përfundim të shkollimit, banorët mbi moshën 65 vjeçare, anëtarët e familjes së ngushtë që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur, invalidët e luftës dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Janë të liruar veteranët. Pika 1, paragrafi 1.4 i nenit 16, rregullohet kur të përpunohet rregullorja. Të kategoritë që lirohen nga shërbimet shëndetësore, e bëjmë veteranët dhe anëtarët e familjes së ngushtë të veteranëve.

**z. Brahim Imishti:** Po ndërlidhem të kërkesa e Arditës. Me gjithë respektin për policinë, ushtrinë dhe zjarrfikësit, ka edhe kategori tjera të cilave mundem me iu mbetur në borgj. Nëse është mundësia në një të ardhme të afërt, nga këto shërbime shëndetësore me u liruar të gjithë qytetarët e komunës së Kaçanikut.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë e potencova këto kategori që përballën me rrezikun 24/7, përndryshe me UA janë të liruara 14 kategori nga pagesa e këtyre shërbime shëndetësore. Shuma 1 € është simbolike, por të jetë një falënderim për kontributin e dhënë dhe ky lirim të vlejë deri sa të bëhet sigurimi shëndetësor. Është e drejta e secilit sesi voton dhe me i dhënë propozimet e vërejtjet e tyre që i kanë.

**z. Naim Beça:** Do të ishte mirë që të gjithë qytetarët e komunës së Kaçanikut të jenë të liruar nga taksat e tilla, ndërkaq ndarja e punëtorëve të tillë nëpër institucione, nuk është e logjikshme, për arsye se kemi shumë pensionistë që e kanë gjendjen me të rënduar, sesa kategoritë që u përmenden: policët, zjarrfikësit, ushtarët. PDK dhe LDK janë të djathtë dhe bëjnë politika të djathta, ndërkaq ne jemi majtë, dhe ne i bëjmë kërkesa të tilla. Ata të institutit shëndetësor, a paguajnë këto taksa apo jo, sepse edhe këta janë në shërbim 24 orë? Nëse nuk janë të liruar atëherë pse me i ndarë. Edhe ne si anëtarë të KK jemi të rrezikuar sa herë. Kategorizimi i personave që punojnë në organet shtetërore, mendoj se nuk është në rregull me i ndarë, se nëse nuk paguajnë të punësuarit, atëherë cila është logjika me paguar ata që janë pa punë? Nuk jam kundër askujt, asnjë kategorie që u potencua se kryejnë punë të rrezikshme, por ndarja nuk është e mirë, ose po i bëjmë krejt shërbimet pa pare, ose të paguajnë krejt.

**znj. Ardita Rrahmani:** Të drejtën në KK e kemi secili nga ne, me dhënë propozime, edhe të drejtën e votën, në KK kushdo propozon çka të donë, dhe e drejta e secilit është sesi voton, pavarësisht bindjeve politike që u përmendën, kjo çështje politike nuk duhet me qenë. Tre kategoritë të cilat i potencova, nuk janë me shumë se 250 persona. 50 veta nuk me bëjë mua anëtar të KK apo tjetrin kryetar, kjo ka të bëjë në situatën që jemi, në mungesë të sigurimeve shëndetësore. Ju e keni të drejtën e plotë me menduar ndryshe, votoni kundër. Po iu drejtohem Naimit, pa të keq dhe anëtarëve të tjerë të LVV, se me u drejtua mua si LDK, po e marrë të drejtën e plotë se e përfaqësoj këtë grup, se nuk është e drejtë me u etiketuar se je djathtist e po e jep këtë propozim. Është e drejtë e imja individuale, e keni të drejtën e juaj me votua apo mos me votua. Përndryshe duhet me ritheksuar me ua bërë me dije secilit që po na përcjellë, ka shumë shërbime që QKMF i ofron ndaj policëve, për të cilat nuk marrin pagesë. Unë e potencova lë të jetë mirënjohje e komunës jo e imja. E dyta, të rikujtoj Naim, se në muajin maj të vitit të kaluar, janë aktivizuar pagesa e shërbimeve shëndetësore, me propozimin tim, e jo të juaj. Kategoritë që po kërkoj me u liruar, është propozim, ju nuk po propozoni, por në anën tjetër kur unë propozoj, ju akuzoni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mirë është me u liruar të gjithë qytetarët nga taksat shëndetësore, por mundësia nuk është, se institucioni funksionon prej taksave. Ne duhet gjetur forma të ndryshme me rritur buxhetin e komunës, nga taksat dhe forma tjera. Si kategori nuk mundemi me i ndarë, se të gjithë janë meritor në fushën e vet, policia e Kosovës duhet të trajtohet me ligje të veçanta të shtetit të Kosovës. Në aspektin komunal, nuk janë kategori që ne duhet të ndajmë nga punëtorët tjerë, si arsim, shërbyesit civil që kanë paga jashtëzakonisht të ulëta. Kërkoj mirëkuptimin e Arditës në këtë rast, se po bëhet dallim, pa dashur me mohuar kontributin e askujt e në veçanti policisë dhe FSK. Kategoritë që janë të liruara nga këto shërbime, janë invalidët e punës apo të luftës, pensionistët, veteranët që po hynë për herë të parë, si një nderë e respekt për kontributin dhe sakrificën e tyre. Çka do që shtojmë apo heqim diçka të kategoritë tjera, gabojmë, se për ne duhet të trajtohen të gjithë njësoj, të gjithë janë kontribuues.

**z. Naim Beça:** Unë kategorizimin e politikave as LVV nuk e ka bërë për ju, kjo është çështje politike tash, ne jemi politikë, jeni deklaruar, partitë politike i caktojnë taksat. Unë me qenë në pushtet, asnjë nuk paguan si parkingjet, pronat e komunës nuk i lë me paguar dhe unë me këtë emër e kërkoj votën. Sa i përket atyre që punojnë, ata marrin rrogë, ndoshta kishte qenë mirë që emergjenca të jetë pa pagesë për krejt, ndërkaq të mjekësia familjare me pagesë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Tjetër është me folur ju si Naim, tjetër është si parti. Ju LVV i keni do komuna kur taksat janë të njëjta me ne, dhe kjo nuk është gabim, se shteti funksionon prej taksave.

**znj. Ardita Rrahmani:** Për njoftimin e juaj, MPB ka dy muaj që ka arritur marrëveshje me QKUK, për ofrimin e shërbimeve pa pagesë dhe prioritizimin e policëve të Kosovës. Unë po kërkoj ajo që është bërë në nivel qendror, të bëhet edhe në nivel lokal. Kjo është vetëm për policinë, se FSK është në kudër të ministrisë së Mbrojtjes. Taksat komunale është e drejtë ekskluzive e komunës me i përcaktuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** FSK duhet me pasur edhe spitalin e vet, besoj se ka shërbime shëndetësore edhe brenda FSK. Unë po themi se, kategorizim të lirimit të shërbimeve nuk bënë me bërë, se këtu janë taksat e ulëta, e jo për taksa enorme që ndikojnë në jetën e qytetarëve. Është shumë e drejtë që kategorive të luftës si shenjë nderi dhe respekti, janë liruar nga taksat komunale, megjithëse shumica e shërbimeve -taksa administrative munden me u shkarkuar drejtpërdrejtë pa para, por kategoritë që punojnë që marrin paga nga buxheti i Republikës së Kosovës, është mirë ti trajtojmë të gjithë njësoj. Propozimi shkon me ndryshimet të kontratat

mjekësore të kategorive të veteranëve të luftës dhe të transporti. Me këtë përmirësim shtrohet në votim kjo pikë. Rezultati i votimit: 23 Për, Kundër janë 4 nga LDK. Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë vendim me të cilin,

**AAPROVOJ**

**Rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale/Lënda: 01Nr. 104/02-8228/25.**

**6.**Propozim-Vendim Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale, pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ky propozim vendim është shqyrtuar në KPF, ka pasur diskutime se a është funksional me 4 anëtarë. Komisioni ka qenë funksional, çështja është një gabimi teknik që nuk është hequr emri i Rrustem Zenunit. Ka edhe shumë kërkesa të qytetarëve, por edhe shumë rrugë që nuk janë përfshirë, por jemi në fund të mandatit dhe mundet mos të na lejohet, se duhet se paku 6 muaj para mbajtjes se zgjedhjeve lokale. Ky propozim i komisionit është sjellë me disa emërtime, me një ndryshim, që në KPF nuk ka kaluar emërtimi "Bamirësia" se kanë pasur mospajtime të komunitetit, është tërhequr derisa të arrihet pajtimi i komunitetit. E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Unë edhe në KPF e kam shprehur shqetësimin, se komisioni nuk i ka marrë për bazë krejt kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, nuk i ka trajtuar në bazë të pritjeve që janë adresuar në DUKMM dhe DSHPE. Është kërkesa e banorëve të një lagjeje të f. Kovaçec, të cilën komisioni nuk e ka marrë në shqyrtim, as përgjigje nuk i është kthyer me shkrim, kërkesa e ka pasur edhe numrin e kontaktit. Konsideroj se ky komision nuk e ka kryer punën në përpikëri. Unë kam me kërkuar qasje në dokumente publike, me kuptuar që kërkesat që janë miratuar, a janë pas kërkesës së lagjes së Kovaçecit, apo janë kërkesa që kanë ardhur nga lagjet e militantëve të PDK?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Këtu kemi të bëjmë me një mori rrugësh, mos të mundoheni me i dhënë kahe politike kësaj çështje, se ka banorë të gjitha subjekteve politike në këto rrugë. Për çështjen që e ngrite, nuk mundemi me ia hedhur fajin komisionit, se ajo rrugë ende nuk është konfiguruar si rrugë publike. A është faji të drejtoria apo të zyrtarët e urbanizmit, unë nuk e di, por të paktën për me marrë në trajtim komisioni, duhet me konfiguruar si rrugë publike. Komisioni ka mundësi që ende nuk e ka pasur as si kërkesë, dhe nuk mundemi me akuzuar komisionin për një rrugë që nuk ekziston akoma. Diskutime të tjera nuk ka, e shtoj në votim për aprovim. Rezultati i votimit, 18 Për (PDK-12, AAK-1, Kandidati i Pavarur-1 LDK-4), Kundër 7-LVV, Abstenoj 1- Agim Çaka. Prezentë 26. Nuk është Burim Shehu. Në saje të rezultatit të votimit, konstatohet se Kuvendi mori këtë:

**VENDIM**

**Për Emërtimin dhe Riemërtimin e Rrugëve Lokale, pas Shqyrtimit të Ankesave, Kërkesave dhe Propozimeve nga Qytetarët e Komunës së Kaçanikut/Lënda: 01Nr. 06-350/01-8267/25.**

7. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është një pikë që u trajtua edhe në mbledhjen e kaluar, jo për situatën që u krijua, por duke u thirrur në Raportin e KKSB, se nuk u dinim se kush duhet të jetë përgjegjës për kamerat e sigurisë. Ishte kërkesë që prezentë të jetë dikush nga stacioni policor. Tani është ndërruar komanda e stacionit policor, kryetari me njoftoj se komandanti nuk merr pjesë me në takim, se nuk është me komandant, për me sqaruar çështjen që u raportua në KKSB, komandanti i ri, sa e ka marrë detyrën. Pavarësisht kësaj, ne nuk do të thotë se nuk mundemi me diskutua këtë çështje. Fillimisht me kërkesën e Kadrije, u mbajt një minutë heshtje për

humbjen e jetës së një polici, e potencoj pastaj edhe Ardita. Organet e rendit janë në procedim të lëndës dhe personave që akuzohen si të dyshuar për këtë çështje. Në të gjitha emisionet dhe debatet, fatkeqësisht jemi bërë temë diskutimi, që për mendimin tim është i panevojshëm në këtë aspekt, duke trajtuar Kaçanikun si vend i ekstremizmit dhe radikalizmit. Ne të gjithë që jetojmë në këtë komunë e dimë se nuk është ashtu, mund të ketë raste individuale, por nuk mund të trajtohet një vend i tërë me një epitet të tillë. Ka pasur reagime individuale edhe nga anëtarët e KK edhe nga zyrtarët. Kryetari ka qenë disa herë në studio të TV, ne duhet të debatojmë për çështjen e sigurisë në komunën tonë, ndërkaq ky si rast është duke u trajtua dhe merren me të organet e rëndit, ndërkaq ne duhet të përmbahemi nga diskutimet, duhet të trajtojmë si akt kriminal që ndodhë në komunën tonë, pavarësisht motivit. Ngjarja që ndodhi, e ka rënduar diskutimin tonë të sotëm, se kishim diskutuar pak me ndryshe, kërkesa jonë i parapriu kësaj që ndodhi dhe lidhet me gjendjen e sigurisë që u kërkua me debatua për kamerat e sigurisë, element ky që ndikon direkt në çështjen e sigurisë në komunën tonë.

**znj. Arta Avdiu:** Çështja e kamerave të sigurisë ka dalë nga raporti i Komitetit për Komunitete, e jo nga KKSB.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me falni, gabim e kam shqiptuar, se çështja e kamerave të sigurisë ka dal nga raporti i Komitetit për komunitete, faleminderit për përmirësimin.

**z. Ekrem Livoreka:** Propozoj që kjo pikë të mbetet për mbledhjen vijuese, se ne jemi sqaruar me kryetarin se në kompetencë të kujt janë kamerat e sigurisë. Komiteti për Komunitete e ka nxjerrë në pah që kamerat e sigurisë nuk funksionojnë. Ne kemi dashur me u sqaruar me komandantin, por fatkeqësisht nuk është këtu. Për mbledhjen e ardhme me qenë edhe komandanti dhe me ua sqaruar në kompetencë të kujt janë kamerat e sigurisë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo pikë është futur ne rend pune për me u sqaruar ne, jo ju si komitet, sepse në raport të komitetit për komunitete shkruan ndryshe, kështu që kemi dashur me u sqaruar, shtjelluar atë që shkruan në raport, se në raport shkruan që kryetari nuk ka pasur interesim dhe vullnet për çështjen e kamerave të sigurisë.

**z. Ekrem Livoreka:** Për çështjen e kamerave të sigurisë, qëllimi është me u sqarua Kuvendi i Komunës, jo Komiteti për Komunitete. Thëniet në raport janë të komandantit të policisë, nuk i kemi thënë ne si komitet. Raporti i Komitetit për Komunitete është në vija të trasha.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë në fillim e ceka se, çështja e raportit ka qenë qëllimi me u sqaruar, komandanti nuk është këtu, ndërkaq kjo nuk na pengon neve mos me trajtua. Unë fola tani për një çështje që është bërë temë e Kosovës, nuk jemi duke folur më se kush është kompetent për çështjen e kamerave.

**z. Ekrem Livoreka:** Çështjet po mbesin vetëm në letër, puna nuk po kryhet. Ne nuk po e dimë kush i ka fajet pa qenë prezentë komandanti i policisë, komuna apo komandanti i policisë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komandanti i policisë nuk është prezentë dhe nuk mundemi me folur me në emër të tij, por për temën e sigurisë mundemi me fol, se di sa po me kupton.

**z. Ekrem Livoreka:** Po ju kuptoj shumë mirë, ne mundemi me diskutuar çështjen sigurisë, por unë e kam fjalën për çështjen e kamerave të sigurisë.

**Kryetari i Komunës:**|Çështjen e sigurisë e kam bërë unë si temë. Qëllimi i takimit ka qenë një raport i Komitetit për Komunitete, ku është cituar fjala e komandantit të policisë se ka munguar vullneti i kryetarit për çështjen e kamerave të sigurisë. Nëse iu kujtohet ishte në pyetje a me votuar apo jo raportin. Unë për mos me hezituar me ardhur komandanti, i kam thënë se keni ftesë për mbledhjen të KK për çështje të sigurisë, dhe u pajtua. Atë ditë është diskutuar vetëm

raporti a me u votuar apo jo, që komandanti ka cituar se ka munguar vullneti i kryetarit për çështjen e kamerave të sigurisë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Pyetja ka qenë e imja, kam kërkuar me ditur a funksionojnë kamerat e sigurisë? Sepse sipas raportit, kamerat e sigurisë nuk kanë funksionuar që 1 vit e gjysmë.

**Kryetari i Komunës:** Çështja ishte se komandanti ka thënë se ka munguar vullneti i kryetarit për rregullimin e kamerave. Unë shumë i qartë isha. Kemi qenë në korridor me Naimin kur i kam ftuar komandantin e policisë, për çështjen e sigurisë, ashtu i kam thënë, që me u sqaruar çështja e kamerave të sigurisë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Çështja ka qenë, me ditur në përgjegjësi të kujt janë kamerat e sigurisë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kryetari, sqarimin e vet e ka dhënë atë ditë në mbledhje se kush është kompetent për kamerat e sigurisë. Na ka mbetur edhe sqarimi i komandantit të policisë, se kush i ka në kompetencë, por sot nuk mundemi me trajtuar si temë, se komandanti nuk është. Komandanti që emëruar tani, ka 1-2 ditë, kështu që në një takim të radhës ka me u trajtuar kjo temë, edhe pse kryetari e ka trajtuar në KKSB këtë temë dhe aty u pajtuan që janë përgjegjës për kamerat e sigurisë, por këtu nuk ka ardhur me u pajtua para neve.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Rasti që ka ndodhur, nuk është e lehtë për askënd. Ne jemi banorë të një qyteti që krenohemi me historinë e Kaçanikut, me vlerat, njerëz të ndershëm dhe mikpritës. Kaçaniku ka qenë gjithmonë vend i qëndresës, bashkëjetesës dhe krenarisë kombëtare, dhe për këtë secili nga ne ka arsye të ndihet krenar. Pikërisht se e duam këtë qytet, nuk mundemi të qëndrojmë të heshtur, por të përballemi me sfidat serioze për sigurinë e vendit. Para 1 muaji ngrita publikisht shqetësimin në KK se kamerat e sigurisë nuk funksionojnë me shumë së 1 vit. Mungesa e tyre nuk është një dështim teknik, por dështim institucional. Në një kohë kur e dimë të gjithë se rreziku është fakt i përditshëm, qyteti i jonë ka mbetur pa mjetin me të thjeshtë për parandalimin dhe hetimin e krimeve. Vetëm pak ditë, pas këtij reagimi, ndodhi një tragjedi, që e tronditi të gjithë, u vra rreshteri i Kosovës, një zyrtar që punonte për rendin dhe mbrojtjen e qytetarëve të këtij vendit. Ju shprehi ngushëllime familjes Lika, Kjo ngjarje në çdo vend normal, do të ishte një pikë reflektimi, një pikë kthese për reflektim dhe ndërgjegjësim institucional, por jo këtu në Kaçanik. Kryetari i komunës në asnjë prononcim të tij publik, nuk e përmendi faktin që kamerat e sigurisë nuk janë në funksion me shumë se 1 vit. U zgjodh heshtja në vend të transparencës, u zgjodh shmangia në vend të përgjegjësisë. Mandej në mbledhjen urgjente të KKSB, shkrimi që është bërë në rrjete social, se raporti nuk është publikuar ende, kamerat nuk janë përmendur fare. Ju nuk e konsideruat të rëndësishme të diskutoni për një çështje që ndërlidhet drejtpërdrejtë me ngjarjet e rënda që kanë ndodhur në qytetin tonë. Për shkak që e duam këtë qytet, ne nuk mundemi ti mbyllim sytë, para realitetit, nuk mund të bëjmë sikur nuk e dimë se është djegur objekti i gjykatës, nuk heshtim para faktit se ekziston një grup ekstremist fetar, por jo sikurse na citojnë të gjitha vendet tjera se i gjithë vendi ekstremistë fetar, por ekziston një grup i cili përbën kërcënim serioz për rendin dhe sigurinë tonë. Të heshtës përballë këtyre fakteve, është bashkëfajësi, të merr shmangësh përgjegjësinë, është dëm i drejtpërdrejtë për qytetarë. Si është e munduar që një komunë që qeveriset prej 16 vitesh nga i njëjti kryetar apo me shumë se një çerek shekulli nga e njëjta parti, të arrijë në këtë gjendje, ku qytetarët nuk ndihen të mbrojtur, nuk ndihen të përfaqësuar dhe mbi të gjitha nuk ndihen të sigurt në qytetin e tyre. Kryetar, si është e munduar që sa vite në KKSB si organ me i lartë i sigurisë, asnjëherë nuk është diskutua për grup ekstremist fetar që është i rrezikshëm për vendin tonë. A është rekomanduar ndonjëherë nga ju si kryesues i kësaj, ndonjë veprim dhe pse nuk keni vepruar me herët kryetar, cilat janë arsyet?

**Kryetari i Komunës:** Me se paku, me vjen mirë që po i donë qytetarët e komunës së Kaçanikut, edhe ne nuk i duam me pak se ju, mos thoni që ne i duam e të tjerët nuk i duan. E dyta, ju po flisni për kamerat e sigurisë, që unë nuk jam kompetent dhe nuk mund të flas as sot as nesër për një çështje që nuk është në kompetencën time. E treta, për këto grupet që po thua ti, asnjë informatë as me të vogël, pos portaleve, unë nuk e kam nga të dhënat zyrtare as nga MPB për shkak të ndjeshmërisë as diçka tjetër. Kështu që nuk me mbetet diçka me thënë mua, për një çështje që nuk është në kompetencën time. Sa i përket asaj sesa punojë që sa vite, 12 vjet, 14 apo 16 vite, është çështje që na vlerëson qytetari. Tjetra, sa përket asaj se nuk e kemi diskutuar në KKSB, ne e kemi pasur komandantin, zëvendëskomandantin dhe 3 zyrtarë tjerë policor (të cilët mund t'i ftojmë)që kanë ardhur me kërkesë tjetër, për shtimin e kamerave të sigurisë, nëpër vendbanime ku mendojnë se janë me të rrezikuar, dhe pikërisht nga ai takim, ata janë d akorduar, kanë thënë kryetar, ne e dimë se nuk është kompetencë e juaja mirëmbajtja e kamerave të sigurisë, por po kërkojmë tani e tutje me një kërkesë që nëse keni mundësi si komunë me na i rritë kamerat (shtimin e kamerave) në vende ku ata mendojnë se janë me të rrezikuara- në vende me të frekuentuara, kurse pjesën e mirëmbajtjes, ata kanë mbetur me rregulluar me MPB. Kjo është ajo çështja që është diskutuar në zyrën time, se janë edhe tre zyrtarë tjerë që munden me argumentuar, se një është i suspenduar, një i larguar. E kam ftuar zyrtarin e prokurimit në zyre për me dëshmua edhe një herë, se cila është forma me i mirëmbajtur kamerat e sigurisë? Me ka thënë: Kryetar, ligjërisht nuk kemi të drejtë. Nëse ju na impononi, ne e hapim procedurën, por dije se nuk e kemi në përgjegjësi. Është diskutuar qysh është çështja e mirëmbajtjes në Han të Elezit dhe në Ferizaj, nuk ka askund direkt mirëmbajtje të kamerave të sigurisë. Në Ferizaj është mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe në kuadër të saj e bëjnë edhe mirëmbajtjen e kamerave, gjë që edhe unë po dua me vepruar ashtu, e kam hapur procedurën për mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë në shkolla, të njëjtën kohë do të mundohemi edhe për mirëmbajtjen e kamerave tjera të sigurisë, por jo ligjërisht se nuk kam të drejtë me mirëmbajtur një aset që nuk është i komunës.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kryetar, a jeni kryesues i KKSB. A është organi me i lartë për sigurinë e vendit tonë? A është rekomandues KKSB?

**Kryetari i Komunës:** Po.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është rekomanduar jo një herë, por disa herë, janë raportet e KKSB.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Po flas në bazë të raportit. Asnjëherë nuk kemi pasur kërkesë për këtë grup. Në mbledhjen e fundit, kryetari i BIK, a ka thënë se kemi pasur kërcënime?

**Kryetari i Komunës:** Nëse mundesh se pari lexoj raportet se nuk paskeni lexuar asgjë, se kryetari i BI 10 herë e ka ngritur shqetësimin jo një herë të komandanti i policisë dhe komandanti iu ka përgjigjur se, ne i kemi marrë kërkesat, i kemi dorëzuar në gjykatë, nuk dimë me shumë, mos thuaj që nuk janë ngritur asnjëherë në KKSB se nja 10 herë është ngritur në 4 vitet e fundit. Herën e fundi është diskutuar edhe me zëshëm, kryetari i BI e ka ngritur edhe çështjen e flamurit ku u hoq në 2 xhami edhe problemin që ua kanë zgjidhur në muajin e ramazanit edhe në xhamitë tjera e deri të konflikti që kanë ra shpesh, ku i kanë marrë policia e kanë dhënë deklaratë në polici dhe i kanë kthyer. Të gjitha i ka ngritë kryetari i BI në KKSB.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Ju si kryesues i KKSB, çka keni rekomanduar dhe çka është marrë në bazë të atyre rekomandimeve, se ju vetëm mbani mbledhje, diskutoni për problemet, nuk rekomandoni, nuk veproni. A keni rekomanduar ndonjëherë me u rregullua kamerat e sigurisë të dëmtuara nga kompanitë gjatë punimeve? A e keni dënuar kompaninë që i ka dëmtuar kamerat e sigurisë? Në mbledhjen e kaluar keni thënë se kompania gjatë punimeve i ka dëmtuar kamerat e sigurisë.

**Kryetari i Komunës:** Unë kam thënë, nëse kompania i ka dëmtuar kamerat e sigurisë, kompania e merr përgjegjësinë. Kompania duhet me ngritur shqetësimin të atij që iu ka bërë dëmi. Kompania kudo që dëmton diçka gjatë punimeve, duhet me kthyer në gjendje të me parme, por pa e lajmëruar kompania nuk merret me atë çështje.

**znj. Arta Avdiu:** Edhe në raport është e cekur se kamerat janë larguar, gjatë punimeve në rrugë. Ka 1 vit e gjysmë që janë hequr kamerat.

**Kryetari i Komunës:** Punimet në atë rrugë janë bërë që tre vjet, por të janë pështjellë gjërat.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo çështje u diskutua në mbledhjen e kaluar. Kryetari e ka sqaruar se nuk ka kompetencë për mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë. Nuk jeni të paskrupullt për çështjet të cilat duhet me fol me përgjegjshmëri. Janë do tema të cilat duhet me u diskutua pa politikë. Meqë nuk ka kuorum, bëjmë një pauzë, pastaj kthemi me vazhduar mbledhjen.

Pas pauzës u vazhdua me punimet e mbledhjes aty ku kanë mbetur. Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj kuorumin, në sallë janë 16 anëtarë(5 nga PDK,7 nga LVV,3 nga LDK, 1-NISMA). Tema që e kemi, duhet me diskutuar pak me qetë, me tonë me të ulët, se janë tema të ndjeshme, ka familjarë që janë prekur nga rasti, duhet me pasur ndjeshmëri të gjithë e mos me i dhënë epitete dhe epilogë që ne nuk na takojnë, sepse janë organet e rendit të cilët merren me këtë çështje, ata e japin vlerësimin dhe vërdiktin e fundit për këtë çështje, kështu të jemi të kujdesshëm, se mundemi me lënduar dike.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ngjarjet e ditëve të fundit në gjithë territorin e komunës, nuk përkojnë me diskutimet dhe raportimet në KKSB. Këtë temë, e kemi shtjerrë debatin në këtë KK para dy seancave, kur është diskutuar raporti i KKSB, edhe në KPF. Mundësitë për të pasur qasje në jetën kulturore aktive, për fat të keq, të rinjtë e këtij vendi i kanë të kufizuara, mos të themi inekzistente. Një qytet si Kaçaniku, me një histori të pastër ndër vite, është i padukshëm në aspektin kulturor. Kur flasim për sigurinë e ofruar në institucionet, kemi ende rrugë të qytetit, nuk po flas për rrethinën, që nuk janë të mbuluar me ndriçim publik. Nga ndriçimi publik, e ndërlidhi edhe temën e kamerave të sigurisë, për të cilën temë është debatuar shumë, me theks, një qytet me 27 mijë banorë, nuk ka asnjë kamerë aktive të mbikëqyrur nga institucionet kompetente. Për rastin në fjalë, uroj dhe jam e bindur që institucionet e Kosovës të vënë drejtësinë do në vend. Deri atëherë, i lutemi secilit të jetë i përmbajtur në gjuhën, sepse ka peshë publike.

**z. Naim Beça:** 1. Së pari, po me vjen keq që disa anëtarë të pozitës nuk janë këtu, por që të kuptojmë mirë, që komandanti i policisë, z. Halim Shehu, nuk është i suspenduar, ai ka vepruar në Kaçanik, dhe ne si KK e kemi kërkuar përgjegjësinë me qenë pjesëmarrës gjatë kohës sa është këtu. Atij duhet me ia bërë një kërkesë, pasi që ai ende është shërbyes në polici, me ardhur me na sqaruar për deklaratat të cilat i ka dhënë, sipas raportit që është sjellë këtu, që e ka hartuar komisioni. 2. E dyta, ne si opozitë shumë herë kemi ngritur çështjen e sigurisë-temë kjo shumë e gjerë, njëra nga to, është: çështja e ndriçimit publik. Kemi kërkuar të bëhet sigurimi i trafikut, çështjen e parkingjeve, çështja e qeneve endacak. Kam kërkuar disa herë në KK çështjen e qeneve endacak, se paraqesin rrezik permanent për qytetarë e sidomos të fëmijëve. Kemi pasur edhe shumë kërkesa tjera. Sa janë marrë këto parasysh prej komunës, KKSB apo komisionit, apo kushdo qoftë tjetër, nuk e di, pasi që nuk kemi marrë përgjigje të duhura. Përgjigjet që janë dhënë, sa herë ato 100 fjalë janë përsëritur nga organi kompetent. Unë kam thënë se ka lokale, ku iu shërbehet alkool fëmijëve nën moshën 18 vjeçare. Edhe kjo çështje hynë në grupin e sigurisë. Shitja e cigareve me copa fëmijëve, i kam pa vet në korzo të qytetit. Edhe pse janë në kompetencë të policisë dhe inteligjencës së komunës, çështja e shitjes së drogës. Çështja e sigurisë është temë shumë e gjerë, por nëse flasim për këtë temë, këto duhet me i përmendur të

gjitha. Ka bunkerë që nuk janë pastruar. Ka edhe shumë çështje tjera që lidhen me sigurinë, për të cilën nuk janë marrë masa. Shpresoj që ngjarja e fundit, që u vra polici, nuk e dimë ne se kush, se nuk jemi gjykatë as prokurori, nuk mundemi ne me gjykuar përpara, të jetë motiv për komunën tonë me u marrë masa dhe me u rregullua do çështje, sidomos çështja e qenve endacak, dritat, trafiku, korzo. Këto çështje me u rregulluar jo vetëm në Kaçanik, por edhe në vende tjera, se ka shumë vende ku janë të hapura shatkat e kanalizimeve, edhe kjo është çështje e sigurisë, se njerëzit kanë pësuar nga shatkat, janë lënduar. Prandaj, të jetë kjo motiv për të gjithë ata që janë përgjegjës, edhe pse asnjë drejtor nuk është këtu, drejtorët se paku duhet të jenë këtu, se nuk është në rregull me lëshuar mbledhjen, se nëse anëtarët e KK janë politikan, drejtorët nuk janë politikan, nuk është dashur me lëshuar mbledhjen se pyetjen vlejnë për ta edhe për drejtorin e ambulantes edhe për të gjithë tjerët. Ajo çka duhet me thënë ne, siguria në Kaçanik ka pasur ngecje në shumë elemente, por lë të jetë motivim që këto të rregullohen.

**z. Agim Çaka:** Gabimin me të madh që e kanë bërë kolegët tanë edhe kryetari, është lëshimi i seancës, për shkak se po debatohet një çështje shumë me rëndësi, siç është çështja e sigurisë. Pavarësisht debateve që zhvillohen, që mund të vjen momenti me lëshuar seancën, nuk është mirë me lëshuar seancën, se është një lloj përgjegjësie kur e lëshon seancën, se është mirë me qenë këtu, se kjo çka ka ndodhur, ne subjektet politike duhet të jemi unik për një çështje, me gjykuar dhe dënuar aktin që ka ndodhur, dhe me iu treguar të tjerëve se ne nuk jemi ashtu qysh na përshkruajnë portalet. Ajo qysh po na përshkruajnë nëpër portale, mundet me na dalë kjo që na ndodhi sot, se faktikisht ne nuk po jemi unik. Nuk jemi krejt bashkë këtu, po diskutojmë qetë dhe mirë, për një ngjarje tragjike që na ka ndodhur, që mundet me na ndodhur edhe nesër. E vërtetë se për këtë çështje kemi diskutuar edhe me herët, 2-3 ditë me herët, nuk është keq kur diskutojmë për çështje të sigurisë, siç e potencoj Naimi, çështjen e dritave, rezervuarin e ujit që e potencova me herët, nesër mundet me ndodhë diçka, me thënë ne e kemi ditur, pastaj me thënë se e ka në kompetencë Bifurkacioni, ne apo dikush tjetër. Zyrtarët përgjegjës duhet me qenë këtu, e ne e dimë kush janë zyrtarët përgjegjës, qoftë nivel qendror apo lokal. Ne nuk jemi duke e përcaktuar fajtorin, këtu mundet me së paku me qenë përgjegjës opozita. Ne jemi duke kontribuar për preventivë, për mos me ndodhë çështjet. Kemi njerëz që kryejnë shërbime shëndetësore të cilët nuk janë të profesionit, çka nëse nesër ndodhë një problem? Ju e dini shumë mirë, e dinë kryesuesi, Rrustemi, e dinë edhe drejtori i shëndetësisë. Këto janë çështje që duhet me u marrë me to, që mos me ndodhë rastet. Nëse nesër ndodhë diçka, nuk mundeni me thënë se nuk jemi përgjegjës. Për atë u ndalëm me diskutua dhe është mirë që po përfundojmë seancën, por vërejtjet duhet me i marrë shumë seriozisht kryesues dhe është mirë me marrë masa, se preventiva është me e lehtë dhe me pak e kushtueshme.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është e kuptueshme dhe normale me u zhvilluar debat, me u trajtua tema, por me u fajësua dhe me u etiketuar një person qysh është kryetari, për një çështje që nuk është kompetencë e tij, se po të ishte për ndriçimin publik, e mirëkuptoj plotësisht, se është në kompetenca të kryetarit, por krejt debatin me na e orientuar për kamerat e sigurisë dhe me na sjellë në një gjendje, ku erdhi deri të largimi i kryetarit nga salla, për mua nuk është normale, sepse disa herë e ka theksuar kur e kemi trajtuar si temë, se nuk është në kompetencë të tij, janë organet e rendit që duhet me vepruar. Të ndriçimi publik, kushdo që e ngritë si temë, keni të drejtë, se komuna është përgjegjëse, nuk mundet t'i ikë asaj, ndërkaq të kamerat dallon. Edhe të lëshimi i mbledhjes, ka pasur raste kur edhe të tjerët kanë lëshuar mbledhjen.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Ne si anëtarë të KK, zakonisht jemi këtu për me i trajtuar shqetësimet, me i paraqitur kërkesat dhe ankesat e qytetarëve. Vazhdimisht nëpër qytet është diskutuar me qytetarë se çështja e kamerave të sigurisë është një problem serioz i komunës tonë, shkaku i disa defekteve që mund të ndodhin me automjete, konflikte të personave, që për mendimin tim edhe zyrtarët do të kishin me të lehtë nëse do të funksiononin kamerat. Kur jemi

të çështja e sigurisë, ne anëtarët e KK kemi qenë në njëfarë mjegullie, nuk e dinim qartë se në kompetencë të kujt janë, se nuk ka harmonizim të fjalëve në mes kryetarit dhe komandantit të policisë që i ka thënë në Komitetin për Komunitete, duke ia hedhur fajin njëri tjetrin për përgjegjësinë e kamerave. Unë në mbledhjen e fundit, e kuptova nga kryetari se kamerat e sigurisë janë donacion, dhe tha se nga auditori kam marrë vërejtje se nuk kam të drejtë me i mirëmbajtur asetet që nuk janë të komunës. Nga ana tjetër e kuptova se, komandanti i policisë ka pasur të drejtë, se monitorimi i kamerave iu takon atyre. Ndërkaq mirëmbajtjen e tyre a ka të drejtë me bërë komandanti i policisë apo komuna? Unë kërkova nga kryetari që të bëjë një kërkesë në MPB, dhe të kërkoj nga ministria me një projekt konkret me një Memorandum bashkëpunimi në mes komunës për çështjen e kamerave të sigurisë në komunë. Kryetari pati premtuar se do të bëjë kërkesën, nuk e di a ka bërë, shkaku edhe i ngjarjes se fundit, sigurisht kemi pasur ngarkesa krejt. Mendoj se ne duhet me kontribuar gjithë secili çdo aspekt që shohim, dhe një rekomandim sado i vogël që del nga ne, mos na merrni sikur sulm ndaj pushtetit. Ato janë kërkesa të cilat vijnë direkt prej qytetarëve. A jeni në dijeni kryesues, a e ka bërë kërkesën kryetari në MPB?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë kur bisedova me kryetarin, madje e vërtetoj edhe Arta, që ka qenë pjesë e diskutimeve që janë zhvilluar aty brenda, kanë qenë pjesë edhe inspektorati i policisë së Kosovës, aty është thënë se, mirëmbajtja, monitorimi, shtimi, janë përgjegjësi e organit që i mbikëqyrë kamerat, sepse ne logjikisht edhe me u prishur një kamerë, nuk e dimë, ndërkaq ata e dinë, se iu shkymen kamerat atje brenda dhe ai duhet me marrë masa për rregullimin e tyre, ose me bërë një kërkesë në komunë për me rregulluar, apo me iu drejtuar organeve me të larta, se ata i kanë kompanitë e kontraktuara, që kanë mjetet të sofistikuara se kamerat që janë në qytet, që i mirëmbajnë dhe i përcjellin, kanë pajisje-dronë e mjete tjera. Ata e kanë mekanizmin, por pse nuk funksionon këtu të ne, nuk e di. Ndoshta është momenti me i duhur me i kushtuar rëndësi kësaj çështje, jemi duke folur për njësinë e punëve të brendshme dhe për drejtorinë e policisë së Kosovës, që realisht tani po e shohim se ata e kanë edhe përgjegjësinë, sepse, zingjiri dhe përgjegjësia bien të ata, se askush nuk po e akuzon as ministrin as kryetarin se është drejtoria e policisë që duhet me u marrë me sigurinë e qytetarëve.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** A jeni në dijeni kryesues, a e ka bërë kërkesën kryetari?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Jo, jo është diskutuar pasi ndodhi rasti, dhe çështja u trajtua me seriozitetin me të lartë, jo pse e keni kërkuar ju apo unë, por u trajtua me seriozitet për shkak të rastit që ndodhi. Unë nuk kam qenë pjesë e atij këshilli, besoj se Arta ka qenë dhe mundet t'iu informoj me shumë.

**znj. Arta Avdiu:** Mosfunksionimin e kamerave të sigurisë për herë të parë këtu në KK, e kemi sjellë ne anëtarët e Komitetit për Komunitete, duke na raportuar komandanti i policisë. Çështjet që janë diskutuar, janë procesverbalet, komandanti i policisë, që tashmë nuk është më komandant, fajin ia ka hedhur komunës. Në mbledhjen e fundit që e mbajtëm me 22 të këtij muaji, komandanti e mori fajin mbi vete. Këta që po i ngritin shqetësimet, ende nuk e kanë pa raportin e vitit 2025, se çka është folur në mbledhjen e këtij muaji. Këta iu kanë referuar raportit të vitit 2024, ku në atë raport janë cituar ato fjali. A ka qenë në dijeni komandanti apo nuk ka qenë në dijeni deri në atë pikë, apo ka ndryshuar mendim, ajo është çështje e tij. Komandanti ka thënë se mirëmbajtja e kamerave të sigurisë, është në kompetenca të kryetarit të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ai tjetri tani e ka marrë përgjegjësinë, kanë ndryshuar gjerat se ka ndodhur rasti.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Secili nga ne, që i shtrojmë kërkesat e qytetarëve, pozitë apo pozitë, e kanë një urë lidhëse për të ngritur si shqetësim. Mos të lëmë me ndodhur tragjedi tjera, për me marrë seriozisht këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Askush nuk e mohon që nuk është dashur me u diskutuar kjo çështje, është diskutuar çështja e sigurisë. Unë nuk e di se cilat kamera të sigurisë nuk funksionojnë. Qysh po e dini ju? A e dini se cila kamerë nuk funksionon, se ka shumë kamera?

**znj. Ernesta Krasniqi:** As ne nuk e dimë.

**znj. Arta Avdiu:** Asnjë kamerë nuk funksionon.

**znj. Ardita Rrahmani:** Asnjë kamerë e sigurisë që është e vendosur nuk funksionon që tre vite. Unë këtë çështje e kam ngritur në debatin me qytetarë këtu në komunë, Jeta në Kosovë, përgjigja që me është dhënë nga kryetari, është se nuk janë në kompetencë tonë. Ne po debatojmë një problem, çështja po heshtët, pastaj po ndodhë diçka, po kthehet çështja për 2 vite me herët, kjo nuk është e mirë. Mendoj se ky rast nuk duhet me u ndërlidhë aspak me çështjen e kamerave të sigurisë, se nuk është se për shkak të kamerës nuk po shihet. Kamerat na duhen çdo ditë, jo me rastin në fjalë, lëne rastin në fjalë, se ne nuk kemi kurrfarë informate, nuk kemi kurrfarë të drejtë me hedhur fajin në emër të askujt për atë që ka ndodhur. Ne mundemi me bashkë ndier me rastin, por nuk mundemi me marrë kurrfarë verdikti, kush jemi ne, ne jemi vetëm anëtarë të KK, janë organet kompetente që e marrin verdiktin final. Pse me marrë një barrë që nuk na takon neve.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Ne nuk jemi duke marrë asnjë verdikt, as nuk jemi duke ia hedhur fajin askujt për rastin, por personat që janë përgjegjës për këto kamera, nuk e kam fjalën për rastin, se ne nuk e ditëm që ka me ndodhur rasti pas 2 ditëve, por kamerat e sigurisë na duhen, se mundet me ndodhur ndonjë aksident, duhet me pa rastin sesi ndodhin sulmet ndaj fëmijëve, ndërsa nuk po e lidhim me rastin e fundit, por ra ky rast, të paktën të vetëdijesohemi të kemi një pikë kthese, se këto kamera të sigurisë janë të nevojshme për secilin nga ne. Mua po me pengon që kryesuesi po thotë, e kanë marrë me seriozitet pas tragjedisë, çështjen e kamerave të sigurisë.
**Kryesuesi i Kuvendit:** Kamerat nuk janë rregulluar ende.
**znj. Ardita Rrahmani:** Jo bre nuk është marrë me seriozitet, se asnjë kamerë ende nuk funksionon.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Kryetari i komunës tha se jemi duke u munduar me bërë një kontratë për kamerat e sigurisë.

**z. Naim Beça:** Çështja e sigurisë është shumë e lartë. Një pyetje po ua bëjë: Kush është përgjegjës për shkallët rezervë të çdo banese, në rast të ndonjë katastrofe natyrore? A e dini se shkallët rezervë të banesa e madhe nuk funksionojnë? Qëllimi i imi është me u marrë veprime të nevojshme për çështje të sigurisë. Ne si LVV nuk kemi kompetencë me rregulluar këtë çështje. E dyta, këtu në komunë sa herë që kam ardhur, nuk kam pa mjete kundër fikjes së zjarrit, as këtu në sallë nuk kam pa. Kjo është njëra prej bazave kryesore sa i përket sigurisë. Çdo objekt që ndodhet në Kosovë, me ligj e ka planin emergjent me dal jashtë, nuk e ka pikën ku me u taku, nuk e ka rrugën e daljes, nuk ka shkallë emergjente, nuk ka mjete për fikjen e zjarrit, ndodhë rasti në katin e dytë, nuk janë këto pajisje. Këto që i përmenda janë motiv shtesë për komunën tonë për siguri me të madhe dhe me marrë me shumë seriozitet këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Shumë me të drejtë e keni, por duhet të keni të qartë, por sa i përket fushës për siguri, ne të gjithë duhet të diskutojmë e debatojmë, të gjithë duhet të jemi kërkues e insistuar, por çështja është se ne nuk kemi kompetenca as për ruajtjen e pyjeve, na i kanë marrë edhe rojet e pyjeve, por ne duhet me qenë çdoherë kërkues ndaj atyre që janë përgjegjës, se ndryshe është fjala kur flet si institucion e ndryshe si individ. Në rastin e sigurisë, ne kemi edhe shumë elemente tjera që na shqetësojnë, që na prekin direkt, si përdorimi i narkotikëve në

shkolla që shkatërrojnë rininë, nuk ka dukuri me të madhe, por kjo çështje ne duhet me qenë kërkues, që kur të marrin, rastin të dërgojnë të vendi ku duhet. Këtu duhet me ardhur inspektori, se të bizneset private fjala vjen, nëse diçka gjënë mangët, të shqipton dënimin, nuk ta falë, inspektorët së pari duhet të kontrollojnë institucionet publike, pastaj tjerat.

**z. Naim Beça:** Për atë është KKSB, me i rekomanduar do çështje. Ne kur po bëjmë kërkesa në KK, po e sqarojmë çështjen. Ne askënd nuk po e akuzojmë, por çështja është, për qentë endacak, me bërë një plan, me bërë plan edhe për rrugë, për ndriçim dhe çështje tjera, por kjo nuk po ndodhë. Ne nuk jemi në pushtet me marrë veprime.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në fushën e sigurisë, askush nuk është në pushtet.

**z. Naim Beça:** Duhet me u bërë diçka në aspektin e sigurisë kombëtare, se nuk është çështja veç me shtruar asfalt.

**z. Rrustem Zenuni:** Meqë u zhvillua debat i mirë, po të ishte me herët ky debat, me siguri edhe kolegët tonë, nuk e kishin lëshuar mbledhjen. Lëshimi i seancës erdhi si një lloj proteste ndaj debatit të zhvilluar dhe akuzave që nga kolegia u drejtuan kryetarit, edhe pse ishte përgjigja dhe ishte në dijeni së çështja e mirëmbajtjes së kamerave të sigurisë nuk është në kompetencë të kryetarit. Sa i përket çështjet të sigurisë, aktet kriminale kanë ndodhur dhe mund të ndodhin, uroj të mos ndodhin kurrë, por duhet të dimë ne dhe të tjerët, se për shkak të një ndodhie të tillë, Kaçaniku nuk mundet të merr një epitet të tillë. Për mos me marrë një epitet të tillë, ne duhet të punojmë bashkërisht, sigurisht duhet ngritët edhe vetëdija. Ne duhet si shoqëri bashkërisht të punojmë, të organizohemi, mos të biem pre e individëve të caktuar të cilët janë bërë të mërzitshëm nëpër portale, në faqe e seanca, se për 5 euro, dikush të plason një lajm. Ne nuk duhet harruar që një pjesë e jona këtu, e mbajmë mend luftën, dhe ende mbajmë mend traumat që na sjellën nëpër memorie. Kështu që ne nuk duhet të debatojmë edhe aq shumë për çështjet që na lëndojnë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne fillimisht deshëm me diskutua, a ia vlen apo jo me diskutuar për këtë temë, se me të vërtetë jemi bërë temë e mediave, pa nevojë. Rasti është tragjedi, dhembje , por nuk e di sa ia vlen mediat tërë kohën me u marrë me Kaçanikun. Megjithatë ishte si pikë e rendit të ditës çështja e sigurisë në komunë dhe deshëm me diskutuar, se nesër pasnesër mundet me u keqinterpretuar edhe nga jashtë, sido që të jetë, është në përgjegjësi të secilit.

**z. Agim Mani:** Fatkeqësisht, kur flasim për sigurinë në territorin e komunës së Kaçanikut, ne nuk i kemi organet e sigurisë tonë. Kjo tregon seriozitetin e tyre sesa e kanë përkushtimin për çështjen e sigurisë në komunën tonë. Megjithatë, kryetari është kryesues i KKSB, nënkryetari është pjesë e këtij këshilli. Temë aktuale është bërë funksionimi i kamerave, megjithëse siguria në komunën tonë është me e gjerë se kaq. A e dini pse është bërë? Mosfunksionimi i kamerave nuk është 1 vit apo 2 vite, 3 vite, unë kur kam qenë në Këshill emergjent, edhe Kemali ka qenë aty, që 6 vite nuk funksionojnë kamerat. Ekzistojnë procesverbalet, ku kemi dalë me rekomandime të cilat KKSB i ka përcjellë rekomandimet për mosfunksionim të kamerave. Mirëpo, kryetari nëse nuk ka mundur nga këndi i kryetarit të komunës, ka pasur mundësi si kryetar i KKSB, sepse i ka dy mundësi, rekomandimet e marra në KKSB me i zbatuar si kryetar i komunës, ose anasjelltas, mirëpo nuk e ka marrë asnjë veprim të tillë, për atë është bërë temë çështja e kamerave të sigurisë.

**z. Rrustem Zenuni:** Tregoni një nga veprimet që nuk janë marrë?

**z. Agim Mani:** Ndriçimi publik, a është çështje e sigurisë. Unë në KK kam thënë para dy viteve se në një vend në Semajë nuk funksionon ndriçimi publik, dhe paraqet rrezik për qytetarët, mirëpo që 2 vite nuk është marrë asnjë veprim.

**z. Rrustem Zenuni:** Pjesërisht funksionon ndriçimi publik, se po prishet.

**z. Agim Mani:** Ka 2 vite nuk është marrë asnjë veprim për mirëmbajtje të ndriçimit publik. Nëse për 6 vite nuk mundesh me zgjidhur një problem, atëherë diçka nuk është në rregull, duhet tentuar me gjetur forma për me i vënë në funksionon kamerat.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Krejt jemi pajtuar, por çështja është se për derisa nuk kemi kompetencë për mirëmbajtje të kamerave të sigurisë, se është dikush tjetër kompetent, nuk kemi mundur me vepruar. Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës, e

**DISKUTOJ**

**Çështjen e sigurisë në komunën e Kaçanikut.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 13:27. Nga 27 anëtarë të KK që ishin prezentë në këtë mbledhjes, deri në fund të mbledhjes qëndruan 16 anëtarë, ndërkaq Burim Shehu shkoj gjatë pikës 6, Lirije Dema gjatë pikës 7 -me arsye, ndërkaq pas pauzës që u realizua në pikën 7, në mbledhje nuk u kthyen: Kadri Krivenjeva, Selajdin Troni, Brahim Imishti, Edon Baftiu, Fatmir Bunjaku, Bashkim Krasniqi, Betim Shala, Ekrem Livoreka, Edona Luzha.

| | |
|---|---|
| Procesmbajtës | Kryesues i Kuvendit |
| Makfire Malsiu | Kemal Murseli |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 - Nr.104/02-11055/25
Kaçanik, 19.05.2025

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë , Ligjit Nr.08/L-332 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës Kaçanik,

**Propozon Kuvendit Komunal këtë:**

**V E N D I M**
**PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PA SHPENZUARA NGA VITET PARAPRAKE NË BUXHETIN E KOMUNËS TË VITIT 2025**

1.Me këtë Vendim, bëhet bartja e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2023 dhe 2024 në buxhetin e komunës të vitit 2025.

2.Shuma e mjeteve për bartje nga viti fiskal 2023 në vitin fiskal 2025 eshtë 409,873.41 euro, ndërsa shuma e mjeteve për bartje nga viti fiskal 2024 në vitin fiskal 2025 është 623,168.15 euro. Totali i mjeteve të pashpenzuara nga vitet 2023 dhe 2024, të cilat kërkohen të barten në vitin 2025 është në shumë prej 1,033,041.56 euro.

3.Buxheti i Komunës së Kaçanikut i miratuar për vitin 2025 në shumë prej 12,592,239.00 euro, pas bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga vitet paraprake në shumë prej **1,033,041.56** euro, do të arrinë shumën e përgjithshme prej **13,625,280.56 euro**.

4.Mjetet e pa shpenzuara në shumë prej **1,033,041.56** euro, janë planifikuar të barten si vijon:

- Mallra dhe Shërbime, shuma prej ........................................... 59,502.41 euro;
- Shërbime Komunale, shuma prej ...........................................15,803.12 euro;
- Subvencione dhe Transfere, shuma prej .................................50,954.44 euro dhe
- Shpenzime Kapitale, shuma prej .......................................... 906,781.59 euro.

5.Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë; Shtojcat A dhe B të pasqyrave tabelare e bilanceve të pa shpenzuara nga vitet fiskale 2023 dhe 2024 dhe rindarja e mjeteve të bartura në buxhetin e vitit 2025 në Nënprogramet përkatëse,kategoritë ekonomike dhe kodet e projekteve.

6.Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta përcjellë në Ministrinë e Financave Punes dhe Transfereve.

Me këtë Vendim të njoftohen:
1.KPF
2.Kuvendi i Komunës, dhe
3.Arkivi.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

**KOMUNA E KAÇANIKUT**
**19.05.2025**

**PËR MINISTRINË E FINANCAVE**

**SHTOJCA - A : Bilancet e pa shpenzuara 2023 dhe 2024**

## PASQYRA TABELARE
## E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË VITIT 2023 DHE 2024
## SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE

**1/. HVK-të e pa shpenzuara të vitit 2023**

**Tabela 1.**

| Nr. | Programet Buxhetore | Paga | Mallra dhe Sherbime | Shërbime Komunale | Subvencione & Transfere | Investime Kapitale | Totali : |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Administrata dhe Personeli 16328 | - | - | 0.92 | | 22,835.96 | **22,836.88** |
| 2 | Çështjet Gjinore 19528 | - | 32.12 | - | | | **32.12** |
| 3 | Zyra e Kuvendit Komunal 16928 | - | 2.13 | - | - | | **2.13** |
| 4 | Buxhet dhe Financa 17528 | | 768.18 | | | 82,925.76 | **83,693.94** |
| 5 | Zjarrëfikesit dhe Inspektimet 18432 | - | 0.02 | | | | **0.02** |
| 6 | Zyra Komunale per Komunitete dhe Kthim 19640 | - | 0.27 | | | | **0.27** |
| 7 | Pylltaria dhe Inspeksioni 47108 | - | 0.05 | | | | **0.05** |
| 8 | Bujqësia 47028 | - | - | - | | | **-** |
| 9 | Administrata 73037 | - | 70.37 | | | | **70.37** |
| 10 | Zyra e Kryetarit 16028 | - | - | - | 9,669.19 | | **9,669.19** |
| 11 | Infrastruktura rrugore 18028 | - | | 8,313.28 | | 43,812.15 | **52,125.43** |
| 12 | Sherbimet Sociale 75636 | - | | 1,500.00 | | 41,019.04 | **42,519.04** |
| 13 | Arsimi Fillorë, i Mesëm, i Ulët 93810 | - | | 14.25 | | 52.71 | **66.96** |
| 14 | Arsimi Mesem i Lartë | - | | 117.43 | | 0.99 | **118.42** |
| 15 | Arsimi Parashkollor 92750 | - | 3,422.75 | 2.77 | | | **3,425.52** |
| 16 | Administrata 92140 | - | - | - | 114.00 | 10,000.00 | **10,114.00** |
| 17 | Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik 48028 | - | - | - | - | 9.06 | **9.06** |
| 18 | Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 66445 | - | - | - | - | 183,582.90 | **183,582.90** |
| 19 | Shërbimet Kulturore 85028 | - | - | - | - | 1,607.11 | **1,607.11** |
| | **T O T A L I :** | **-** | **4,295.89** | **9,948.65** | **9,783.19** | **385,845.68** | **409,873.41** |

**2/. HVK-të e pa shpenzuara të vitit 2024**

**Tabela 2.**

| Nr. | Programet Buxhetore | Paga | Mallra dhe Sherbime | Shërbime Komunale | Subvencione & Transfere | Investime Kapitale | Totali : |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Administrata dhe Personeli 16328 | - | 9.42 | 4,304.48 | | | **4,313.90** |
| 2 | Çështjet Gjinore 19528 | - | 180.02 | | | | **180.02** |
| 3 | Zyra e Kuvendit Komunal 16928 | - | 614.55 | | | | **614.55** |
| 4 | Buxhet dhe Financa 17528 | - | 733.46 | | | 98,174.91 | **98,908.37** |
| 5 | Zjarrëfikesit dhe Inspektimet 18432 | - | 286.04 | | | | **286.04** |
| 6 | Zyra Komunale per Komunitete dhe Kthim 19640 | - | 523.00 | | | | **523.00** |
| 7 | Pylltaria dhe Inspeksioni 47108 | - | 21.88 | | | | **21.88** |
| 8 | Bujqësia 47028 | - | - | | 5,274.16 | | **5,274.16** |
| 9 | Administrata 73037 | - | - | | | | **-** |
| 10 | Zyra e Kryetarit 16028 | - | - | | 14,220.00 | | **14,220.00** |
| 11 | Infrastruktura rrugore 18028 | - | - | 10,000.00 | 9,855.97 | 54,943.00 | **74,798.97** |
| 12 | Sherbimet Sociale 75636 | - | - | 2,000.00 | | | **2,000.00** |
| 13 | Arsimi Fillorë, i Mesëm, i Ulët 93810 | - | - | 7,668.67 | | 46,083.62 | **53,752.29** |
| 14 | Arsimi Mesem i Lartë | - | - | 3,000.00 | | 50,000.00 | **53,000.00** |
| 15 | Arsimi Parashkollor 92750 | - | 9,002.54 | 5,000.00 | | | **14,002.54** |
| 16 | Administrata 92140 | - | - | | 1.00 | | **1.00** |
